



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË PUKË

SHTATOR 2019



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME

PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË PUKË

SHTATOR 2019



GJETJET NGA BASHKIA PUKË

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11.069 banorë, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil numëron 16.836 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 505.53 km² dhe përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Puka, Gjegjani, Rrapë, Qelëz dhe Qerret. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Pukës dhe e qarkut Shkodër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 41 fshatra.

GJETJET - STAFI I BASHKISË

Për përgatitjen e këtij raporti u pyetën 10 punonjës të Bashkisë Pukë, të cilët përfshijnë: staf drejtues dhe specialistë nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Punëve Publike dhe Shërbimeve, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Ndhmës Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Urbanistikës dhe dy administratorë të njërive administrative. Të intervistuarit përfaqësojnë drejtori dhe sektorë që janë të përfshira në procesin e BP.

- Të gjithë të intervistuarit në Bashkinë Pukë shprehen që ekzistojnë mekanizma të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët. 70% e tyre pohojnë se konsultimi me publikun gjatë BP-së, së bashku me paketën fiskale, është njëri prej tyre, ndërsa të tjerët flasim për takime e dëgjesa publike (ndonjëherë edhe me specialistë përkatës), pa specifikuar llojin apo tematikën e këtyre takimeve. Një nga format e konsultimit që veçohet prej punonjësve të bashkisë është edhe komunikimi i drejtëdrejtë apo periodik me qytetarët, por edhe kjo formë mbetet e pasqaruar sesi kryhet.
- 60% e të intervistuarve mendonin që procesi BP kishte vetëm 1 vit që zhvillohej në Bashkinë Pukë, 20% e tyre 3 vjet dhe 20% 5 vjet. Pavarësisht dijënisë së tyre në lidhje me kohëzgjatjen e tij, burimet zyrtare konfirmojnë se BP ka nisur të zbatohet në këtë bashki mbas vitit 2013. I vetmi proces i organizuar në mënyrë efektive është bërë nga Partners Albania përmes mbështetjes së Olof Palme Center në periudhën 2016-2017. Bashkia Pukë nuk ka bërë asnjëherë procese të buxhetimit gjinor.
- 80% e të intervistuarve mendojnë se procesi është iniciuar për herë të parë nga organizata të shoqërisë civile në bashkëpunim me bashkinë dhe vetëm 20% e tyre e shohin zanafillën e tij prej Bashkia. Të gjithë mendojnë bien dakort që procesi është nisur dhe realizohet si rezultat i drejtpërdrejtë i detyrimit ligjor që bashkitë kanë për ta kryer këtë proces.
- 60% e të intervistuarve iu përgjigjën pozitivisht pyetjes nëse ka rregullore apo vendime të miratuara nga KB apo Kryetari i Bashkisë për mbarëvajtjen e procesit BP, ndërsa 20% nuk kishin dijeni dhe 20% dhanë përgjigje negative. Pavarësisht se shumica u shprehën që ka rregullore apo vendime për procesin BP, vërehet mungesa e dokumentacionit përkatës ose moseskzistenca e një praktike të mirëfilltë në këtë Bashki. Të intervistuarit nuk dinin të jepnin përgjigje pse nuk ka një model apo praktikë të tillë. Nga burimet pranë

Bashkisë Pukë u konfirmua që nuk ka vendime apo rregullore të miratuara në lidhje me procesin dhe zbatimin e BP.

- Shumica e stafit të bashkisë të intervistuar u shprehën që kishin dijeni për organizimin e procesit BP, por hapat e ndërmarra nuk ishin shumë të qarta prej tyre dhe asnjë nuk mundi t'i përmendte dot gjithë etapat nga fillimi në fund. Asnjë i intervistuar nuk flet për finalizimin e procesit nga KB. Nga përgjigjet vërehet që ka konfuzion dhe mungon një praktikë e ndërtuar qartë e saktë për zhillimin e procesit në të gjitha hallkat e tij.
- 100% e të intervistuarve mendojnë që struktura përgjegjëse për organizimin e BP është Drejtoria Ekonomike me strukturat e saj, pa përmendur një grup apo strukturë të caktuar që do ta organizonte dhe lehtësonte këtë proces. Stafi i Bashkisë Pukë i pyetur se cilat drejtori apo sektorë të tjerë të bashkisë përfshihen në BP duket se nuk e mendon shumë gjithëpërfshirës këtë proces. 70% e tyre mendonin që vetëm Drejtoria Ekonomike përfshihet në procesin BP dhe pjesa tjetër deklarojnë drejtori të tjera që bëhen pjesë e tij, të tilla si arsimito-kultura, shërbimet, urbanistika, bujqësia, ujësjellësi apo reparti i zjarrfikëses.
- Të pyetur për mjetet e njoftimit dhe përfshirjen qytetare në këtë proces të intervistuarit në shumicë u shprehën se lajmërimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe afishimi në ambjentet e institucionit ishin mënyrat e përdorura më shumë prej bashkisë. 70% e tyre raportonin që regjistri elektronik nuk përdorej asnjëherë e pjesa tjetër që lajmërimet individuale përmes email apo telefonatave dhe njoftimet në gazetën lokale përdoren më rallë.
- Për sigurimin e të gjitha grupeve të synuara në proces duket se renditen të njëjtat mjete të përmendura më sipër, përfshirë dhe njoftimin individual nëpërmjet administratorëve, por nga përgjigjet nuk vihet re përfshirja e kryeqendrave në fshat. Të gjithë të intervistuarit mendojnë që ka nevojë për përmirësim të këtij procesi duke theksuar infrastrukturën e përshtatshme në funksion të procesit, që do të siguronte gjithëpërfshirje, informim e transparencë me qytetarët.
- 50% e të intervistuarve mendojnë që regjistri elektronik ekziston në Bashkinë Pukë, 40% që nuk janë në dijeni të tij dhe 10% që nuk ka një të tillë, por 100% e tyre nuk janë në dijeni që regjistri të publikohet online. Shumica e tyre nuk e dinte si funksiononte apo kush e përditësonte regjistrin (e ngatërronin me Zyrën e Protokollit) dhe nuk ishin në dijeni të strukturës përgjegjëse në bashki për përditësimin e tij.
- Të pyetur a mbahet apo publikohet procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun, vetëm 30% e tyre u shprehën "gjithmonë apo "shpesh", ndërkohë që pjesa tjetër nuk ishin në dijeni të këtij procesi. Më keq ishte njohuritë e tyre në lidhje me statistikat e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto procese (përfshirë edhe BP). Asnjë nga të intervistuarit nuk kishte dijeni për ekzistencën e shifrave, e aq më tepër të ndara sipas gjinisë, njësive administrative, të rinjve, grupeve të marginalizuara, OSHC, etj, gjë që e

bënë shumë të vështirë punën e Bashkisë për njohjen dhe zgjidhjen e problematikave sipas grupeve të interes dhe jo vetëm.

- Në Bashkinë Pukë duket se nuk ka një sistem monitorimi dhe vlerësimi të procesit të BP, pasi 80% e të intervistuarve e konfirmojnë këtë ose nuk kanë dijeni nëse ka një të tillë. E njëjta situatë vërehet kur pyeten për indikatorët që maten apo kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e tij. Vërehet konfuzion mes procesit të monitorimit dhe vlerësimit të BP dhe atij të nxjerrjes dhe përcaktimit të prioriteteve, i cili është një nga hapat e procesit BP dhe nuk ka të bëjë me monitorim/vlerësimin.
- Punonjësit e Bashkisë i lidhin sfidat që hasin në zbatimin e buxhetimit me pjesëmarrje kryesisht me mungesën e buxheteve të mjaftueshme për të kryer investime (gjë që sipas tyre ka ulur besimin e qytetarëve ndaj institucionit). Ata shprehen se qytetarët presin më shumë nga bashkia, pavarësisht se pjesëmarrja e tyre në takimet publike është e ulët dhe shtrirja e madhe territoriale e bënë informimin e tyre edhe më të vështirë. Gjithsesi ata shprehen se aktivizimi i qytetarëve përmes procesit të BP është përmirësuar deri diku, por ka shumë për të bërë, sidomos për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve dhe shpeshimin e takimeve dhe konsultimeve me qytetarët.
- Si nevojat kryesore për përmirësimin e këtij procesi të renditura nga stafi i Bashkisë janë rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve, asistencës teknike dhe shkëmbimit të eksperiencave; përmirësimi i burimeve financiare dhe sigurimi i infrastrukturës së përshtatshme për realizimin e këtij procesi. Më konkretisht 100% e të intervistuarve shprehen për përmirësim të burimeve njerëzore, 90% e tyre përmendin asistencën teknike dhe trajnimet, 100% burimet financiare dhe 40% infrastrukturën e përshtatshme.

GJETJET KËSHILLI BASHKIAK

Pas zgjedhjeve vendore 2015, Këshilli Bashkiak Pukë numëronte 15 këshilltarë vendorë, nga të cilët 4 gra (26.6%) dhe 11 burra (73.4%). Këshilli i ri bashkiak i dal si rezultat i zgjedhjeve lokale të mbajtura në 30 qershor 2019 ka në përbërjen e tij 15 anëtarë, nga të cilat 3 gra (25%) dhe 12 burra (75%), kryesisht të forcës së majtë. Në Bashkinë Pukë nuk është ngritur një Aleancë e Grave Këshilltare, shpjeguar kjo edhe me faktin e numrit të ulët të përfaqësimit të grave në këtë Këshill. Për përgatitjen e këtij raporti, u pyetën 10 ish-anëtarë të Këshillit Bashkiak.

- Në përgjithësi të gjithë këshilltarët e shikonin shumë të rëndësishme dhe të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset konsultuese dhe vendimarrëse. Sipas të intervistuarve është e rëndësishme që qytetarët të jenë të përfshirë pasi duhet marrë në konsideratë mendimi i tyre dhe janë ata që sjellin nevojat reale që komuniteti ka. Pati këshilltarë që u shprehën se stafi i bashkisë nuk është i mirëkualifikuar dhe ka mungesë të profesionistëve. Sipas tyre qytetarët mund ta bëjnë më mirë këtë punë duke i identifikuar problematikat më mirë se ata.

- 60% e të intervistuarve mendojnë se e njohin bazën ligjore mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor, por jo se kanë marrë ndonjë trajnim specifik në lidhje me këtë. Po i njëjti grup u shpreh se legjislacioni është i qartë dhe plotë, por shpesh i pamundur të zbatohet. 30% e këshilltarëve mendojnë është “i paqartë” dhe “jo i plotë” dhe 10% refuzuan të përgjigjen. Të pyetur nëse mendonin që baza ligjore përkatëse ka nevojë për rishikim apo plotësime, shumica e tyre nuk dinin të përgjigjeshin.
- 80% e këshilltarëve mendojnë që nuk ka një rregullore apo procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit të BP dhe 20% e tyre pohuan të kundërtën, por nuk zotëronin ndonjë kopje të dokumentacionit përkatës dhe u shprehën që edhe pse ka nuk zbatohen asnjëherë.
- Vetëm 20% e të intervistuarve mendojnë që ka bashkëpunim mes këshillit bashkiak dhe bashkisë për procesin e BP-së (shihet një ndarje politike ku përfaqësuesit e pozitës thonë që ka bashkëpunim, kurse ata të opozitës e mohojnë). E njëjta ndarje vërehet edhe në pyetjen për infrastrukturën e realizimit të procesit. Sipas tyre, bashkëpunimi realizohet përmes zyrës së financës dhe Komisionit të Ekonomisë dhe më pas me koordinimin e takimeve me publikun.
- Të pyetur se cilat janë mjetet që përdor bashkia për njoftimin e procesit BP, të intervistuarit u përgjigjën se forma më e përdorur është lajmërimi publik i afishuar në ambjentet e bashkisë (90%), lajmërimi në mediat sociale (90%) dhe ato në mediat lokale (70%). Vetëm 35% e tyre mendojnë se njoftimet bëhen përmes postës elektronike (e-mail). Nga përgjigjet e këshilltarëve vërehet se regjistri elektronik dhe botimet në gazetata lokale nuk janë mjete të përdorshme nga bashkia për njoftimin e procesit BP, pasi asnjë i intervistuar nuk i renditi në zgjedhjet e tyre.
- Është e dukshme që Këshilli nuk një mekanizëm monitorimi dhe raportimi të procesit BP, pasi 90% e tyre u shprehën negativisht. I vetmi këshilltar që pohonte ekzistencën e këtij mekanizmi mendonte që ky proces bëhej përmes Komisionit të Ekonomisë, i cili paraqet raportin për Këshillin Bashkiak pas verifikimit të kryerjes së procesit.
- 70% e të intervistuarve shprehen që Bashkia raporton në KB për Buxhetimin me Pjesëmarrje dhe rekomandimet që dalin prej procesit dhe 100% e tyre thonë që ato miratohen të përfshira në projekt buxhetin e propozuar nga Bashkia. Të gjithë të intervistuarit përgjigjen që nuk ka asnjë rast të kthimit nga Këshilli të projekt vendimeve për BP. Por duket që nuk ka ndjekje nga Këshilli të zbatimit të vendimeve që merren prej tyre në lidhje me BP, pasi 90% e këshilltarëve përgjigjen negativisht.
- Të pyetur nëse kanë dijeni dhe a përdoren mekanizmat që sigurojnë pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët për veprimtarinë e KB, shumica e këshilltarëve (përveç njërit) shprehen që përdorimi i tyre është “ndonjëherë”, “shumë rrallë” ose “asnjëherë”, gjë që flet për punën e pakët që bëhet për këtë proces të rëndësishëm me qytetarët.

- Të pyetur në lidhje me aktet dhe dokumentat e miratuara dy vitet e fundit për të cilat janë kryer konsultime me publikun, 90% e të intervistuarve përmendin vetëm buxhetin vjetor (së bashku me paketën fiskale) dhe buxhetin afatmesëm. Nga përgjigjet vërehet se Këshilli nuk ka qenë i përfshirë në konsultime që kanë të bëjnë me planet strategjike apo projekte të investimeve që kryen bashkia.
- Shumica e këshilltarëve të Bashkisë Pukë shprehen se kënaqësia e qytetarëve lidhur me mekanizmat që përdor Këshilli nuk matet asnjëherë. Po ashtu ata mohojnë në 90% që marrin ankesa nga qytetarët apo grupe interesi lidhur me pjesëmarrjen në konsultimin publik. Dikush shprehet se nganjëherë ankohen se nuk ka informacion kur organizohen konsultimet apo dëgjesat publike, por nuk merren parasysh. Pavarësisht se iu përgjigjen negativisht pyetjes nëse marrin ankesa (3 ankesa gjithësej në dy vitet e fundit), në pyetjen tjetër shumica e tyre shprehen se ato trajtohen në mbledhjet e këshillit, ngrihen grupe pune për të bërë verifikimin dhe pastaj kthehet përgjigje me shkrim. Ka raste që thonë se qytetarët njoftohen edhe përmes medias lokale.
- 100% e këshilltarëve të intervistuar shprehen se nuk ka ndonjë sistem monitorimi dhe vlerësimi të mekanizmave të përdorur nga këshilli apo bashkia. Gjithashtu në të njëjtën masë ata mohojnë marrjen apo miratimin e raporteve vjetore të hartuara nga bashkia për transparencën e proceseve vendimarrëse.
- Pavarësisht se në përgjigjet e mëparshme këshilltarët u shprehën se kishin njohje të bazës ligjore për angazhimin dhe konsultimin e publikut në vendimarrjen vendore, thuajse 100% e tyre e vlerësojnë veten me kapacitete të ulta për realizimin e proceseve të konsultimit publik. Më konkretisht, 35% e konsideronin veten “pak të aftë” dhe 65% “jo të aftë”. Siç u shprehën më sipër, atyre u mungon trajnimi i duhur për aftësimin e tyre në rolin si këshilltarë vendorë.
- 70% e tyre mendojnë që RAT ka ndikuar për zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik, e lidhur kjo me shtrirjen gjeografike që Bashkia ka dhe distancën e madhe për dhënien e informacionit dhe marrjen e shërbimeve në kohë.
- Sfidat që lidhen me angazhimin dhe konsultimin me publikun këshilltarët e Bashkisë Pukë i lidhin kryesisht me mungesën e koordinimit mes institucionit të bashkisë dhe KB dhe mungesën e informacionit. Ndër sfidat e tjera ata rendisin pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve si rezultat i besimit të ulët ndaj vendimarrësve, buxhetet e ulta për realizimin e prioritetëve dhe kërkesave të qytetarëve dhe ambientet e papërshtatshme.
- Nga përgjigjet e dhëna për nevojat për përmirësim të punës së tyre si këshilltarë, ata u shprehën se ka shumë nevojë për rritje të kapaciteteve të tyre përmes trajnimeve, asistencës teknike dhe shkëmbimeve të eksperiencave. Shumica e tyre kërkuan rritje të buxheteve dhe infrastrukturës së përshtatshme, ndërkohë që dikush kërkonte

përcaktimin e një modeli që do të drejtonte procesin BP që do të kishte një ndarje të mirëspecifikuar të rolit të bashkisë dhe të KB.



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**